



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 01/09**

**Prishtinë, më 18.11.2009, ora 10:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10**

**P R O C E S V E R B A L**

**nga mbledhja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike**

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Haki Shatri, Safete Hadërgjonaj, Kosara Nikolić, Gani Koci, Arsim Rexhepi, Anita Morina, Sinavere Rysha dhe Enis Kervan.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Riza Smaka.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Vilson Ukaj,** dhe stafi i KIPRED në përkrahje të Komisionit (**Artan Venhari dhe Qemajl Marmullakaj**).

**Kryesues: Haki Shatri, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

1. Takim njoftues;
2. Përkrahja e Komisionit;
3. Diskutim mbi mandatin e Komisionit;
4. Caktimi i Mbledhjeve të ardhme ardhshme
5. Të ndryshme

## **1. Takim Njoftues**

**Kryesuesi**, pasi hapi mbledhjen konstituive të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njoftoi për përbërjen e Komisionit.

## **2. Përkrahja e Komisionit**

**Kryesuesi**, njoftoi anëtarët e Komisionit për përkrahjen teknike dhe profesionale që do të ketë ky Komision nga ana e KIPRED-it me financim nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore. Ai theksoi se ky Komision si një shembull në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të vazhdojë, shpresojmë, edhe në vitin e ardhshëm të përkrahet nga KIPRED-i dhe ekspert vendorë dhe ndërkombëtarë, që këta do sjellin në Komision. Në këtë drejtim në fillim të vitit të ardhshëm do të realizohet një vizitë në një vend në të cilën ekziston ky komision, për të parë përvojat e funksionimit të tij. Ai gjithashtu u ndal në Tryezën e Rrumbullakët të organizuar nga KIPRED me datën 09.10 2009, ku u prezantua një hulumtim nga praktikant rajonale dhe ndërkombëtare të mbikëqyrjes së financave publike, ku veçoi edhe mandatin e propozuar për Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

**Artan Venhari**, prezantoi në pika të shkurtra përkrahjen e KIPRED për Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

## **3. Diskutim mbi mandatin e Komisionit**

**Kryesuesi**, prezantoi para Komisionit një propozim të shkruar të qartësimit të mandatit të Komisionit dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të marrin parasysh këtë dokument, dhe në mbledhjet tjera do të diskutohet për mandatin që do të ketë ky Komisionit, që pastaj ta kanalizojmë në strukturat e Kuvendit.

**Gani Koci**, theksoi që mandati duhet të jetë pjesë e diskutimit të përgjithshëm të Kuvendit dhe jo të ndahet nga tërësia e Kuvendit. Ky komision mund të bëjë propozime, të cilat duhet të dorëzohen në Komisionin për Rregulloren e Punës së Kuvendit, që më pas edhe mandati i tij të jetë i rregulluar qartë me Rregulloren e re të punës së Kuvendit. Gjithashtu për mandatin e këtij komisioni ne duhet të konsultohemi me praktikant më të mira të vendeve të ndryshme dhe pastaj të vendosim për mandat. Ndërsa sa i përket çështjes së përcaktimit të kompetencave në mes këtij komisioni dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa, ky i fundit mund të bëjë edhe mbikëqyrjen e shpenzimeve buxhetore, si dhe nuk ka konflikt interesi pjesëmarrja e anëtarëve në të dy komisionet.

**Anita Morina**, shprehu mendimin e saj kundër që një anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa të jetë edhe anëtar i këtij komisioni, me arsyetimin se një anëtarë që miraton buxhetin, nuk duhet ta bëjë kontrollin e shpenzimeve të atij buxheti.

**Enis Kervan**, theksoi se në materialin e propozuar për mandatin e këtij komisioni, duhet të shqyrtohen disa pika të propozuar, sidomos paragrafi 4 pika c, ku thuhet se një nga anëtarët e këtij komisioni i komunitetit pakicë duhet të jetë nga opozita, e që në realitet të dy anëtarët e caktuar në këtë komisioni nga komunitetet joshumicë, jemi nga pozita. Do të duhej të analizohen

këto propozime dhe shfaqja besimin që në mbledhjet e radhës do të kemi edhe komente të tjera shtesë.

**Safete Hadërgjonaj**, shprehi mendimin e njëjtë me z. Koci lidhur me mandatin e Komisionit, që kjo çështje të rregullohet me Rregulloren e punës së Kuvendit. Në pjesën më të madhe të vendeve ekziston si nën-komision i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe jo si komision i ndarë, të cilin e udhëheqë opozita. E rëndësishme është që të qartësohet mandati midis dy komisioneve, që mos të ketë duplikim të punës dhe të dihet se cili komision me çka do të merret. Gjithashtu theksoi se nuk konsiderohet konflikt interesi që anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa të jenë edhe anëtarë të këtij komisioni.

**Kosara Nikolić**, ekzistojnë vende që e kanë dhe që nuk e kanë këtë komision, mirëpo të qenit anëtarë i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike nuk duhet të jetë problematike. Përkundrazi është mirë që ata që miratojnë buxhetin, të kontrollojnë atë.

**Synavere Rysha**, vlerësoi materialin e përgatitur dhe të propozuara për mandatin e këtij komisioni, i cili donë shqyrtim më të hollësishëm për të dal me propozime konkrete. Ndërsa në çështjen e përbërjes së komisionit, theksoi se anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk duhet të jenë edhe pjesë e këtij komisioni, pasi që ata shqyrtojnë raportet financiare dhe do të bënin punë të dyfishtë.

**Kryesuesi**, pasi shpjegoi se propozimi për mandatin e komisionit është versioni pune, theksoi se mandati nuk është imponim nga askush mirëpo duhet të jetë pjesë e diskutimeve tuaja me grupet parlamentare dhe pastaj të shprehni mendimin tuaj në mbledhjet e ardhshme. Më pas do të kërkohet nga komisioni përkatës të harmonizojë ato dhe të inkorporojë në kuadër të Rregullorës së Punës së Kuvendit.

**Arsim Rexhepi**, mbështeti propozimet që të konsultohen përvojat e shteteve për të parë si e kanë të rregulluar këtë çështje. Kjo do të eliminon edhe çështjen se a është konflikt interesi që anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa të jenë pjesë e këtij komisioni.

#### **4. Caktimi i Mbledhjeve të ardhshme**

Pas diskutimit dhe propozimeve të anëtarëve prezent për ditën e mbajtjes së mbledhjeve të komisionit në të ardhmen, u vendos që orientimisht dita e martë, të jetë dita kur ky komision do të mbledhet.

Mbledhja përfundoi në ora 10:45

Përgatitur nga  
Njësia për mbështetjen e Komisionit

**Kryesuesi i Komisionit,**  

---

**Haki SHATRI**